



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 55, date 24.06.2019

PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR TË NDERIT
“MIRËNJOHJA E BASHKISË SHKODËR” ZNJ. ZENEPE DIBRA

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 19.06.2018, me propozim të këshilltarit z. Filip Guraziu, mbështetur në nenin 54 shkronja “m”, neni 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 15 të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 61, datë 30.11.2016 “Rregullore për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre“, relacionit datë 11.06.2018 të komisionit këshillimor për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Dhënien e titullit vendor të nderit “Mirënjohja e Bashkisë Shkodër” znj. **Zenepe Dibra**, me motivacionin:

“Intelektuale e shquar e qytetit të Shkodrës, me kontribute të vyera në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, si zbatuese, autore projektesh dhe pedagoge. Anëtare aktive e shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe autore e një seri botimesh enciklopedike mes të cilëve “Fjalor enciklopedik i hapësirës shqiptare shkodrane” (Vol.1-2) e para dhe vetmja enciklopedi për qytetin e Shkodrës deri me sot”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 24.6.2019

Shpallur në datën 24.6.2019

Sekretar i këshillit

K R Y E T A R

Suel Hadri

Xhemal BUSHATI